

VENDIM
Nr.370, datë 14.6.2006

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË ADMINISTRATËS SË PREFEKTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nivelet e pagave për funksionet e mëposhtme të jenë:

- | | |
|---|---------------|
| a) Prefekt i qarkut të Tiranës | 107 500 lekë; |
| b) Prefektë të qarqeve të tjera | 99 000 lekë; |
| c) Nënprefekt i Kavajës dhe Lushnjës | 84 000 lekë; |
| ç) Nënprefekt i Krujës, Pogradecit, Librazhdit, Tepelenës, Përmetit, Matit, Sarandës, Pukës, Tropojës dhe Skraparit | 78 000 lekë ; |
| d) Nënprefekt i Malësisë së Madhe, Bulqizës, Peqinit, Gramshit, Devollit, Mallakastrës, Hasit, Kuçovës, Mirditës, Delvinës, Kurbinit dhe Kolonjës | 72 000 lekë; |
| dh) Këshilltar i prefektit të Tiranës | 55 000 lekë; |
| e) Zëdhënës i prefektit të Tiranës | 45 000 lekë. |

2. Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit e administratës së prefektit janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Paga e grupit (kolona 1) e lidhjes nr.1 – diplomë e shkollës së lartë është 10 050 (dhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë.

4. Shtesa për vjetërsi pune (kolona 2) jepet në masën 2 për qind , pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

5. Shtesa për kualifikim (kolona 3) është 0.

6. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 4 të lidhjes nr.1.

7. Nëpunësit, të cilët punojnë në pozicionet “Specialist” deri “Sekretar i Përgjithshëm”, që nuk përmbushin kriterin e arsimit të lartë të trajtohen me pagë sipas strukturës së përcaktuar në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, por paga e grupit të llogaritet me 50 për qind të pagës së grupit për diplomën e shkollës së lartë, sipas përcaktimit të bërë në pikën 3 të këtij vendimi. Shtesa për vjetërsi, për këta nëpunës të llogaritet mbi këtë pagë të reduktuar.

8. Nëpunësit e tjerë të administratës së prefektit të paguhen sipas lidhjes II-5 “Pagat bazë sipas klasave për punonjësit e ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore”, të vendimit nr. 726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, të ndryshuar.

9. Lidhja II-12, “Niveli i pagës për punonjësit e prefekturave”, e vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, të ndryshuar, dhe të gjitha dispozitat e tjera, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

10. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2006, të përballohen nga fondet e planifikuara për rritjen e pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

	PAGA MUJORE				
EMËRTIMI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4

		Paga e grupit (PG) lekë	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV) përqindje	Shtesa për kualifikim (SHK) lekë	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
Sekretar i përgjithshëm në prefekturë	III-a	10 050	2%	0	59 714
Sekretar i përgjithshëm në nënprefekturat Kavajë dhe Lushnjë	III-a/1	10 050	2%	0	49 942
Përgjegjës sektori në prefekturë	III-b	10 050	2%	0	43 428
	IV-a	10 050	2%	0	32 571
Përgjegjës zyre në prefekturë Përgjegjës zyre në nënprefekturë	IV-a	10 050	2%	0	32 571
Përgjegjës sektori në nënprefekturë Inspektor auditi në prefekturë	IV-a	10 050	2%	0	32 571
Specialist në prefekturë	IV-b	10 050	2%	0	21 714
	IV-c	10 050	2%	0	16 286
Specialist në nënprefekturë	IV-c	10 050	2%	0	16 286
Sekretar	IV-c	10 050	2%	0	16 286